



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2 pika d dhe të nenit 17, pika b e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/ 15, qershor 2008), të dispozitave të Ligjit nr. 04/L - 174 për planifikim hapësinor, të nenit 15, paragrafi 15.1, pika b dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2013, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN
"PRISHTINA E RE - QENDËR" NË PRISHTINË

I.

1. Miratohet Plani rregullues urban "Prishtina e Re - Qendër" në Prishtinë.
2. Plani nga paragrafi 1 i kësaj pike, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi dhe ka sipërfaqe prej 360 ha.

II.

Në bazë të planit të miratuar sipas këtij vendimi, do të caktohen kushtet e ndërtimit, sipas të cilave do të miratohet dokumentacioni që ka të bëjë me ndërtimin, sipas destinimit të shfrytëzimit të tokës të parcelave ndërtimore brenda kufijve të këtij plani.

III.

Kushtet e ndërtimit sipas pikës II të këtij vendimi, do të përcaktohen nga organi kompetent i Komunës së Prishtinës për punë të urbanizmit, në baze të kriterëve të përcaktuar me këtë plan rregullues urban, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi gjatë zbatimit të këtij plani.

IV.

1. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunë së Prishtinës.

2. Organet tjera kompetente të Komunës do t'i kryejnë veprimet procedurale nga përgjegjësitë e tyre të caktuara me ligj për zbatimin e këtij plani.

V.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes së Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr 035 - 186861, më 02.10.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.

